



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2020:000900

Datë: 29.09.2020

Numri i dokumentit: 01148649

**A.nr.10/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në konfliktin administrativ të paditësit [“G...”] LL.C me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson [“S...”], kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/14679 i datës 27.11.2019, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, jashtë seancës, me datë 28.09.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR** ankesa e paditësit [“G...”]LL.C me seli në Prishtinë, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

**A r s y e t i m**

Paditësi [“G...”] LL.C me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në këtë Gjykatë përmes te autorizuarit te tij, me datë 06.01.2020, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/14679 i datës 27.11.2019.

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka gjetur se padia e paditësit nuk e përmban vërtetimin për pagesën e taksës gjyqësore.

Gjykata me anë të vërejtjes gjyqësore të datës 28.02.2020 dhe 07.08.2020, e ka ftuar të autorizuarin e paditësit të paguajë taksën gjyqësore në shumë prej 50€, e paraparë me Ligjin e Procedurës Kontestimore nr.03/L-006, dhe atë brenda afatit 15 ditësh nga dita e marrjes së vërejtjes gjyqësore, te cilën vërejtjes gjyqësore paditësi sipas fletë kthesës së nënshkruar e ka pranuar me dt.11.03.2020dhe 02.09.2020.

Meqenëse paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksave gjyqësore, gjykata duke u bazuar në nenin 253.5 të LPK-së, e konsideron si të tërhequr ankesën për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal**  
**A.nr.10/20, me dt.28.09.2020**

**G j y q t a r i**  
**Ramush Bardiqi**

**KËSHILLË JURIDIKE**

kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 60 ditësh, nga dita e pranimi të aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate

Numri i lëndës: 2020:000900  
Datë: 29.09.2020  
Numri i dokumentit: 01148649